



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 26.05.2023

Nr: 152

Ora: 12:10

VENDIM I NDËRMJETËM

PËR SHQYRTIMIN BASHKËRISHT TË KËRKESAVE ANKIMORE NR. 67, DATË 20.05.2023 DHE NR. 74, DATË 22.05.2023

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 26.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 67, datë 20.05.2023 dhe nr.74, datë 22.05.2023

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “dh”, 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 19 të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Data: 26.05.2023 Nr: 152
Ora: 12:10



“Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 67, datë 20.05.2023 dhe nr. 74, datë 22.05.2023”

VËREN:

Subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 67 regj., datë 20.05.2023.

Z. Lefter Maliqi, kandidat për kryetar bashkie në bashkinë Kuçovë ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 74 regj., datë 22.05.2023.

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, në datën 26.05.2023, me vendimet nr. 136 dhe nr. 151, vendosën të kalonin për shqyrtim dy kërkesat e paraqitura në KQZ. Relatorët ekërkesave ankimore përkatësisht z. Koli Bele dhe z. Ilirjan Rusmali konstatuan se të dy kërkesat kishin të njëjtin objekt:

- 1. Ndryshimi i vendimit nr. 101, datë 16.05.2023 të ZAZ nr. 64, bashkia Kuçovë, qarku Berat “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kuçovë”.*
- 2. Rinumërimin dhe rivlerësimin e votave për ZAZ nr. 64, në të gjitha qendrat e votimit, duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për QV-të e listuara në tabelë.*

Përsa më sipër, KAS-i vendos bashkimin e kërkesave nr. 67 dhe nr. 74 dhe të shqyrtohen në një seancë. Duke qenë se kërkesa ankimore nr. 67, është regjistruar më parë në regjistrin e ankimeve se kërkesa ankimore nr. 76, datë 22.05.2023, atëherë të dy kërkesat ankimore do të relatohen nga z. Koli Bele.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “dh” dhe 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 19 pika 1, të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”,

V E N D O S I:

1. Shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 67, datë 20.05.2023 dhe nr. 74, datë 22.05.2023.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 01.06.2023 ora 13:30.
3. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Elvin LAKO - Anëtar

Elvis ÇEFA - Anëtar

Ilirjan RUSMALI - Anëtar

Koli BELE - Anëtar